VENDIM
Nr.881, datë 12.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, "MASTER I NIVELIT TË PARË", NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të programeve të studimit "Master i nivelit të parë", në:

a) "Drejtim dhe administrim arsimi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Drejtim dhe administrim arsimi";

b) "Qeverisja dhe politikat publike", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Qeverisjen dhe politikat publike";

c) "Këshillim psikologjik", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Këshillim psikologjik";

ç) "Orientim profesional", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Orientim profesional";

d) "Punë sociale", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Punë sociale";

dh) "Filozofi praktike dhe humane", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Filozofi praktike dhe humane";

e) "Analizë e politikës sociale", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë, "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Analizë e politikës sociale".

2. Programet e studimeve "Master i nivelit të parë" realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha